



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr. 23 regjistër (JR)
Datë 26.05.2023

Nr. 35 i vendimit
Datë 17.07.2024

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Mimoza Tasi	Kryesuese
Rezarta Schuetz	Relatore
Ina Rama	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 17.07.2024, ditën e mërkurë, në orën 14:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejдини, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUESE: Komisionerja Publike, znj. Irena Nino.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 657, datë 28.04.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Periand Teta.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b i Kushtetutës; Aneksi i Kushtetutës; ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Kodi i Procedurave Administrative.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në përputhje me parashikimet e nenit 65, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në

vijim “ligji nr. 84/2016”), analizoi pretendimet në ankim të Komisioneres Publike Irena Nino, si dhe konkluzionet përfundimtare, nëpërmjet të cilave ajo kërkoi ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 657, datë 28.04.2023, ndërprerjen e procesit të rivlerësimit ndaj subjektit të rivlerësimit dhe ndalimin e emërimit të tij si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm për një periudhë 15-vjeçare, si dhe pasi analizoi apelin kundërshtues, parashtrimet dhe kërkimet e subjektit të rivlerësimit, i cili në bisedimet përfundimtare kërkoi lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi ose prishjen dhe urdhërimin e Komisionit të vijojë procesin e rivlerësimit kalimtar, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Rezarta Schuetz, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, z. Periand Teta [subjekti i rivlerësimit] ka ushtruar detyrën e ndihmësit/këshilltarit ligjor në Gjykatën e Lartë. Për këtë arsye, bazuar në nenin 179/b, pika 4 e Kushtetutës dhe pikën 16 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, ai u kualifikua për t’iu nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio* nga Komisioni. Nga aktet në fashikull, rezulton se subjekti ka dorëzuar pranë institucioneve kompetente deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional, bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 e 43 të ligjit nr. 84/2016.
2. Komisioni ka nisur procesin e rivlerësimit për subjektin duke i dërguar pyetësorin standard, të cilit subjekti i ka kthyer përgjigje më datë 02.07.2021 dhe më datë 05.07.2021, duke dërguar edhe provat shkresore.
 - 2.1. Më datë 18.04.2023, Komisioni i ka dërguar subjektit rezultatet e hetimit, si dhe e ka informuar për të drejtën për t’u dëgjuar dhe për të marrë pjesë në seancë dëgjimore. Në rezultatet e hetimit, Komisioni ka arsyetuar se z. Periand Teta nuk është subjekt rivlerësimi, pasi në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ishte i pezulluar nga detyra e nuk përfitonte pagë, sikurse edhe i kishin ndryshuar elementet thelbësore të kontratës së punës, siç ishte vendi i punës dhe pozicioni/detyra. Sipas analizës së kryer nga Komisioni, z. Teta kishte dhënë pëlqim të heshtur për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, duke mos e ankimuar urdhrin e lirimit nga detyra në rrugë gjyqësore që njëkohësisht përbënte dakordësim për përfundimin e kësaj marrëdhënieje. Më tej, Komisioni ka arsyetuar se z. Teta nuk është subjekt rivlerësimi sipas ligjit nr. 84/2016, konfirmuar edhe nga vetë subjekti në kërkesën e datës 28.07.2017, drejtuar Inspektoratit të Lartë të Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”) që, sipas Komisionit, kërkoi të rivlerësohej si ish-këshilltar.
 - 2.2. Nga ana tjetër, Komisioni e gjeti të pambështetur kërkesën e subjektit për t’iu nënshtruar procesit si ish-këshilltar, pasi nuk plotësonte kriterin e vjetërsisë, nisur nga analiza e kryer për periudhën përreth njëvjeçare gjatë së cilës ai ishte i pezulluar nga detyra e nuk kishte përfituar pagë. Komisioni vlerësoi se periudha efektive e punës për z. Teta ka qenë përreth dy vite, e konkretisht, nga data 03.02.2014 deri në datën 18.07.2016, kur u pezullua nga detyra me urdhër të

kryetarit të Gjykatës së Lartë. Në këtë linjë, Komisioni i përmbylli rezultatet e hetimit duke konkluduar se z. Teta nuk ishte as subjekt *ex officio* dhe as subjekt me kërkesë, si ish-ndihmës/ish-këshilltar ligjor dhe vendosi të ftojë subjektin në seancë publike.

2.3. Nga aktet në fashikull, rezulton se fillimisht, në datën 19.04.2023, z. Teta i është përgjigjur pozitivisht kërkesës për t'u dëgjuar në seancë publike, ndërsa të nesërmen, nëpërmjet komunikimit elektronik, është shprehur se pas njohjes me konkluzionin e Komisionit për të përfunduar procedurën pa një vendim përfundimtar [sipas pikës 2 të nenit 65 të ligjit nr. 96/2016 dhe të nenit 103 të Kodit të Procedurave Administrative], nuk do të paraqiste parashtrime e nuk do të ishte i pranishëm në seancën dëgjimore publike.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Me vendimin objekt ankimi, Komisioni vendosi të deklarojë përfundimin e procesit të rivlerësimit, pa një vendim përfundimtar për z. Teta, duke arsyetuar se:

3.1. Z. Teta ka dhënë pëlqimin në mënyrë të heshtur për ndërprerjen e kontratës së punës, duke mos e ankimuar në gjykatë, çka u kualifikua si pëlqim dhe dakordësim i subjektit lidhur me procedurën. Sipas Komisionit, pavarësisht së drejtës që z. Teta pretendonte në shkresën e datës 19.07.2017, drejtuar kryetarit të Gjykatës së Lartë, ai nuk ndërmori asnjë hap ligjor lidhur me sa referon në kërkesën për veprime që cenonin të drejtat e punëmarrësit. Sipas Komisionit, z. Teta nuk ishte subjekt i ligjit nr. 84/2016, për sa kohë nuk e ushtronte efektivisht detyrën e ndihmësit/këshilltarit ligjor në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, dhe nuk e gëzonte cilësinë e subjektit të rivlerësimit.

3.2. Lidhur me kërkesën e subjektit për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit vullnetarisht, drejtuar ILDKPKI-së në datën 28.07.2017, Komisioni vlerësoi se subjekti nuk plotësonte kriterin e vjetërsisë në pozicionin e ndihmësit ligjor, ndaj ai nuk mund të trajtohej as si ish-ndihmës/ish-këshilltar ligjor.

3.3. Për sa më lart, Komisioni konkludoi se ndodhet në kushtet e ndërprerjes së procesit pa një vendim përfundimtar, sipas nenit 95 të Kodit të Procedurave Administrative.

III. Shkaqet e ankimit

a) Ankimi

4. Komisionerja Publike, znj. Irena Nino, ka ushtruar ankim kundër këtij vendimi, duke kërkuar ndryshimin e tij, nëpërmjet ndërprerjes së procesit dhe aplikimit të nenit G të Aneksit të Kushtetutës. Sipas Komisioneres Publike, vendimi i Komisionit është i paqartë, i arsyetuar në mënyrë jobindëse në drejtim të shkakut ligjor për të cilin u përmbyll procesi i rivlerësimit kalimtar sipas nenit 95 të Kodit të Procedurave Administrative e, për pasojë, edhe mosaplikimi i nenit G të Aneksit të Kushtetutës. Ndryshe nga sa ka konkluduar Komisioni, Komisionerja Publike pretendon se subjekti ndodhet në kushtet e ndërprerjes së procesit të rivlerësimit sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

4.1. Në mbështetje të këtij vlerësimi, Komisionerja Publike parashtrori se në rastin konkret, paraqet rëndësi fakti që në kohën e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese dhe të ligjit nr. 84/2016, subjekti ushtronte funksionin e ndihmësit ligjor në Gjykatën e Lartë. Bazuar në jurisprudencën e Kolegjit, duke pranuar të emërohet në një detyrë tjetër, subjekti ka dhënë pëlqimin e heshtur për ushtrimin e detyrës së re.

4.2. Po ashtu, Komisionerja Publike parashtron në ankim se shprehja e vullnetit të largimit nga detyra, ndonëse nuk është bërë me kërkesë formale, mungesa e kundërshtimit në rrugë gjyqësore, së bashku me faktin që menjëherë pas largimit, subjekti ka vijuar të ushtrojë një detyrë të re me pëlqimin e tij, duket shprehje e dakordësisë/pëlqimit të heshtur të subjektit.

b) Apeli kundërshtues

5. Subjekti i rivlerësimit paraqiti një apel kundërshtues kundër ankimit të sipërreferuar të Komisioneres Publike. Nëpërmjet këtij apeli kundërshtues, subjekti kërkoi mospranimin e ankimit si të pambështetur në ligj e në prova. Sipas tij, argumentet janë hipotetike, në kontradiktë të hapur me logjikën arsyetuese në ankim dhe në mungesë të mirëfilltë të fakteve e provave. Këto konkluzione të subjektit bazohen në argumentimin në vijim.

5.1. Objekti i hetimit, kufijtë e shqyrtimit administrativ, analiza dhe vlerësimi i fakteve në Komision janë kryer në nivelin dhe masën e duhur dhe përkojnë me sa është e nevojshme për vendimmarrjen. Në kushtet që Komisioni ka konstatuar mungesën e statusit të subjektit të rivlerësimit, hetimi apo vlerësimi i një sërë rrethanash që ndodhën pas përfundimit të marrëdhënies së punës, nuk ka qenë i nevojshëm.

5.2. Marrja e një detyre të re, referuar nga Komisionerja Publike, bazuar në kërkimet nga burime të hapura, duhet të hetohet nga Kolegji, pasi Komisionerja Publike ka arritur në përfundim mbi rrethana të pahetuara nga Komisioni.

5.3. Përfundimi i marrëdhënies së punës me Gjykatën e Lartë ka ardhur për shkaqe ligjore, të pavarura nga vullneti i shprehur personal. Nuk ekziston lidhje shkak-pasojë mes vullnetit dhe veprimeve të tij dhe përfundimit të marrëdhënies së punës, për shkak të së cilës ai i nënshtrohet procesit të rivlerësimit. Nuk ka dorëheqje apo veprime që diktojnë përfundimin e marrëdhënies së punës. Në zbatim të ligjit të kohës, kohëzgjatja e detyrës së ndihmësit ligjor lidhej me mandatin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

5.4. Nga aktet shkresore¹, konstatohet vullneti i tij i vazhdueshëm, që pavarësisht përfundimit të marrëdhënies së punës në mënyrë të njëanshme nga Gjykata e Lartë, ka kërkuar t'i nënshtrohet procesit të rivlerësimit. Ai nuk ka shfaqur vullnet, qoftë të shprehur apo nëpërmjet veprimeve konkludente, për t'u dorëhequr nga detyra si ndihmës ligjor. Vullneti është shfaqur edhe nëpërmjet

¹ Subjekti referon në parashtrimet e datës 25.06.2024, akte të cilat nuk janë pjesë e fashikujve të përcjellë në Kolegj: shkresën nr. {***} prot., datë 19.07.2017 – drejtuar Gjykatës së Lartë lidhur me ecurinë e marrëdhënies së punës; shkresën nr. {***} prot., datë 01.08.2017, drejtuar ILDKPKI-së për t'iu nënshtrohet procesit të rivlerësimit; shkresën nr. {***} prot., datë 28.07.2017, drejtuar KLD-së, nëpërmjet së cilës paraqet vullnetin për t'iu nënshtrohet procesit të rivlerësimit; dhe shkresën drejtuar DSIK-së, datë 28.07.2017, për të njëjtin qëllim.

plotësimin dhe dorëzimit të deklaratave të parashikuara nga ligji nr. 84/2016, pjesëmarrjes në testimin e zhvilluar nga Shkolla e Magjistraturës në kuadër të vlerësimit profesional të ndihmësve/këshilltarëve ligjorë, si dhe plotësimin dhe dorëzimit të pyetësorit standard e provave në Komision.

5.5. Marrëdhënia e punës në Ministrinë e Drejtësisë ka filluar pas përfundimit të marrëdhënies së punës me Gjykatën e Lartë, për efekt të ekzekutimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë. Pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës nga Gjykata e Lartë, fillimi i marrëdhënies së punës, ishte domosdoshmëri për aspektin ekonomik dhe profesional. Detyrimi për të mos u zhvilluar profesionalisht dhe për të mos ndjekur karrierë profesionale nuk është objektiv dhe as proporcional me procesin e rivlerësimit.

5.6. Në referim të jurisprudencës së Kolegjit, nuk ka vend për aplikimin e nenit G të Aneksit të Kushtetutës. Kjo dispozitë është pasojë e drejtpërdrejtë e ndërprerjes së procesit për të gjithë subjektet, të cilët nuk i nënshtrohen procesit të rivlerësimit me vullnetin e tyre.

6. Në parashtrimet e datës 19.06.2024 dhe konkluzionet e datës 28.06.2024, Komisionerja Publike i qëndroi ankimit dhe kërkoi ndryshimin e vendimit të Komisionit, nëpërmjet ndërprerjes së procesit të rivlerësimit kalimtar dhe aplikimin e nenit G të Aneksit të Kushtetutës, duke ndaluar subjektin për t'u emëruar si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm për një periudhë 15-vjeçare.
7. Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e datës 19.06.2024 dhe konkluzionet e datës 28.06.2024, kërkoi nga Kolegji mospranimin e ankimit të Komisioneres Publike, pasi ai nuk ka shfaqur në asnjë formë vullnet për t'u larguar nga detyra apo shmangur procesin e rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit po ashtu potencoi se masa ndaluese e nenit G të Aneksit të Kushtetutës do të ishte disproporcionale në rastin e procesit të zhvilluar ndaj tij, sikurse edhe në rrethanat konkrete ligjore e faktike, në kuptim të parimit dhe zbatimit në praktikë të konceptit të sigurisë ligjore. Në përfundim, subjekti kërkoi lënien në fuqi të vendimit të Komisionit ose prishjen dhe urdhërimin e Komisionit të vijojë procesin e rivlerësimit kalimtar për të.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) *Juridiksioni i Kolegjit*

8. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka juridiksion të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuara nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) *Legjitimimi i ankuesit*

8.1. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Po ashtu, legjitimohet edhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

8.2. Apeli kundërshtues i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae*, sipas nenit 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016; nenit 1, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, që referojnë në Kodin e Procedurës Civile, konkretisht në nenin 456, që është dispozita që i jep të drejtë palës që të paraqesë apelin kundërshtues brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit të ankimit.

8.3. Sipas akteve në fashikull, më datë 15.05.2023, Komisioni i ka dërguar subjektit njoftimin e pranimit të ankimit të Komisioneres Publike ndaj vendimit objekt shqyrtimi. Nga nënshkrimi i fletëthirrjes, rezulton se subjekti ka marrë njoftimin e ankimit në datën 16.05.2023. Apeli kundërshtues është dërguar në Komision, në datën 19.05.2023, brenda afatit 5-ditor, të parashikuar nga dispozita e nenit 456 të Kodit të Procedurës Civile, duke e legjitimuar kështu edhe *ratione temporis*.

c) *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

8.4. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit ndaj vendimit objekt shqyrtimi zhvillohet në seancë gjyqësore publike. Sipas paragrafit 1/2 të pikës 1 të nenit 20 të rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të Gjykatës Kushtetuese”, çështja që i përket ankimit ndaj vendimit të Komisionit, i cili ka vendosur ndërprerjen/pushimin e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, shqyrtohet me përparësi, pavarësisht datës së regjistrimit në Kolegj.

8.5. Nëpërmjet parashtrimeve të datës 19.06.2024, subjekti i rivlerësimit paraqiti disa akte², shoqëruar edhe me kërkesën për riçeljen e hetimit gjyqësor në Kolegj. Në seancën gjyqësore të datës 24.06.2024, me vendim të ndërmjetëm, trupi gjykues vendosi (i) riçeljen e hetimit gjyqësor dhe (ii) marrjen në cilësinë e provës të akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të cilat plotësonin kriteret e kërkuara nga ligji. Ky vendim bazohet në nenin F, pika 3 e Aneksit të

² Aktet që subjekti kërkoi të pranohen në cilësinë e provës janë: (i) shkresë drejtuar Komisionit nr. {***} prot., datë 15.05.2023; (ii) shkresë e subjektit e datës 25.05.2023, drejtuar KLGj-së; dhe (iii) përgjigje e KLGj-së nr. {***} prot., datë 29.05.2023; (iv) shkresë e subjektit drejtuar DSIK-së e datës 25.05.2023; dhe (v) përgjigjja e DSIK-së drejtuar subjektit nr. {***} prot., datë 01.06.2023; (vi) kërkesëpadi e subjektit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; (vii) vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. {***}, datë 21.02.2018; (viii) ankimi i subjektit i datës 05.03.2018, kundër vendimit nr. {***}, datë 21.02.2018; (ix) vërtetim nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm nr. {***} prot., datë 10.06.2024; (x) vërtetim nga Shkolla e Magjistraturës nr. {***} prot., datë 23.05.2023; (xi) shkresë e subjektit drejtuar Gjykatës së Lartë nr. {***} prot., datë 15.05.2023; (xii) kthim përgjigje e Gjykatës së Lartë drejtuar subjektit nr. {***} prot., datë 16.05.2023; (xiii) shkresë e subjektit drejtuar Gjykatës së Lartë nr. {***} prot., datë 29.05.2023; (xiv) kthim përgjigje e Gjykatës së Lartë drejtuar subjektit, nr. {***} prot., datë 01.06.2023; (xv) kthim përgjigje e Ministrisë së Drejtësisë drejtuar subjektit nr. {***} prot., datë 19.05.2023.

Kushtetutës dhe në nenin 45 të ligjit nr. 84/2016. Për sa këto akte lidheshin me shkaqet e ankimit dhe nevojën e subjektit të rivlerësimit për t'i prapësuar ato, trupi gjykues vendosi t'ia nënshtrojë debatit gjyqësor, e më pas i vlerësoi ato në raport me vendimin objekt shqyrtimi dhe shkaqet e ankimit të Komisioneres Publike.

V. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit

9. Lidhur me statusin e subjektit të rivlerësimit *vis a vis* pezullimit nga detyra të z. Periand Teta:

9.1. Komisioni nuk e konsideroi z. Periand Teta subjekt të rivlerësimit kalimtar *ex officio*, pikësëpari për shkak se në momentin e hyrjes në fuqi të kuadrit ligjor për procesin e rivlerësimit kalimtar, ai ishte i pezulluar nga ushtrimi i detyrës. Në këtë qëndrim, Komisioni potencoi se pezullimi nga detyra, urdhëruar nga kryetari i Gjykatës së Lartë, ka pasur efekt që në korrik të vitit 2016, duke ndikuar kështu në kohëzgjatjen e funksionit. Së dyti, në vijim të kësaj analize, sipas Komisionit, z. Periand Teta nuk mund t'i nënshtrohej procesit as si ish-ndihmës/ish-këshilltar ligjor, pasi ai nuk plotësonte kriterin e tri viteve të përvojës në funksion, si parakusht për qenien subjekt rivlerësimi me kërkesë, në kuptim të pikës 4 të nenit 179/b të Kushtetutës. Për këtë arsye, Komisioni konkludoi se procesi është pa objekt dhe duhet të përfundojë pa një vendim përfundimtar.

9.2. Komisionerja Publike kundërshtoi arsyetimin e mësipërm të Komisionit duke sjellë në vëmendje që edhe vetë Komisioni e konsideroi z. Teta subjekt rivlerësimi deri në rezultatet e hetimit. Në periudhën e ndërmjetme, nga momenti kur nisi procesi i rivlerësimit e deri në rezultatet e hetimit administrativ, nuk ndryshoi asnjë rrethanë që të passillte vlerësimin që z. Teta nuk gëzonte më këtë cilësi. Sipas Komisioneres Publike, Komisioni nuk ka identifikuar drejt shkakun ligjor që ka përbërë kushtin determinant për përfundimin e procesit të rivlerësimit për subjektin pa një vendim përfundimtar. Arsyetimi i Komisionit se z. Teta nuk gëzon statusin e subjektit të rivlerësimit, pasi ka qenë i pezulluar nga detyra dhe nuk ushtronte detyrën në mënyrë efektive, si rrjedhojë, nuk është i bazuar. Pezullimi nuk ka asnjë efekt mbi momentin që e gjeti subjektin në detyrën e ndihmësit ligjor.

9.3. Trupi gjykues i Kolegjit konkludoi se është i bazuar vlerësimi i Komisioneres Publike. Edhe në vlerësimin e trupit gjykues të Kolegjit, pezullimi nga detyra nuk ka asnjë efekt domethënës në kontekstin e statusit të subjektit të rivlerësimit. Për pasojë, vlerësimi i Komisionit se subjekti i rivlerësimit e kishte humbur këtë cilësi për shkak të pezullimit të marrëdhënies së punës në korrik 2016, është i pabazuar në ligj. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit shtjellohet në vijim.

9.4. Z. Periand Teta ka qenë punësuar në Gjykatën e Lartë, si ndihmës ligjor pranë ish-anëtares M. A., në periudhën kohore nga 03.02.2014 deri më 25.07.2017. Gjatë kësaj kohe, e konkretisht, nga data 18.07.2016 deri në fund të periudhës, ai ishte i pezulluar dhe nuk ka përfituar paga³ për shkak të pezullimit të gjyqtares me të cilën punonte, në vijim të një procedimi penal në ngarkim të saj. Kontrata e punës e z. Teta parashikonte që përfundimi i marrëdhënies së punës lidhej me mandatin e gjyqtares në fjalë.

³ Shkresa e kancelarit të Gjykatës së Lartë, me nr. {***} prot., datë 29.03.2023.

9.5. Ndryshimet kushtetuese që parashikuan kuadrin e rivlerësimit kalimtar, hynë në fuqi në datën 11.08.2016. Në atë kohë, subjekti ishte ende këshilltar ligjor pranë Gjykatës së Lartë, ndonëse jo efektivisht në detyrë. Afati i pezullimit të detyrës i filloi efektet nga data 20.07.2016. Pasi gjyqtarja M. A. u dënua me vendim penal të formës së prerë, në datën 19.07.2017, z. Teta kërkoi informacion me shkrim nga Gjykata e Lartë për marrëdhënien e tij të punës. Në përgjigje, kryetari i Gjykatës së Lartë, me urdhrin nr. {***}, datë 25.07.2017, urdhëroi përfundimin e kontratës së punësimit me afat të z. Teta me Gjykatën e Lartë dhe lirim të tij nga detyra, në mënyrë të menjëhershme. Në vijim të këtij urdhri, në datën 28.07.2017, z. Teta i ka dërguar ILDKPKI-së, kërkesën për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, me vullnetin e tij. Sipas akteve, duket se subjekti e ka dërguar të njëjtën kërkesë edhe në organet e tjera ndihmëse [referuar në poshtëshënimin nr. 1].

9.6. Më pas, duke filluar nga data 08.09.2017, z. Teta është rikthyer në një pozicion të shërbimit civil, në vijim të rekomandimit të Ministrisë së Drejtësisë⁴ dhe është emëruar inspektor në Sektorin e Inspektimit dhe Organizimit Gjyqësor, në Ministrinë e Drejtësisë.

9.7. Trupi gjykues i Kolegjit e vlerëson të gabuar analizën e Komisionit që i ka dhënë efekt shues marrëdhënies së punës për shkak të urdhrin të pezullimit. Pezullimi nga ushtrimi i detyrës nuk ka përfunduar marrëdhënien e punës. Nën dritën e nenit 141 të Kodit të Punës, lexuar në harmoni me dispozitat e pikës 4 të nenit 179/b të Kushtetutës që përcaktojnë rivlerësimin *ex-officio* të këshilltarëve ligjorë të Gjykatës së Lartë, pezullimi apo mosushtrimi i detyrës në mënyrë efektive, nuk duhet të ishte argumentuar se ka pasjellë përfundimin e marrëdhënies së punës për z. Teta. Për pasojë, ky pezullim nuk ka pasjellë as humbjen e statusit të subjektit të rivlerësimit, nën dritën e nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës dhe nenit 165, pika 1 e ligjit nr. 96/2016, për çka duhej t'iu nënshtrohej procesit të rivlerësimit kalimtar.

9.8. Gjithashtu, referuar librezës së punës, subjekti vijonte të figuronte në listën e punonjësve të institucionit. Në këtë akt, pasqyrohet qartë që lirim nga detyra/ndërprerja e marrëdhënies së punës me Gjykatën e Lartë është bërë në datën 25.07.2017, dhe jo në momentin e pezullimit. Së fundmi, subjekti nuk rezulton të ketë krijuar marrëdhënie të re punësimi gjatë periudhës së pezullimit deri në përfundimin e marrëdhënies së punës.

9.9. Nga ana tjetër, urdhri për pezullimin nga detyra, sikurse rezulton nga përmbajtja, nuk mund të kishte për qëllim të përfundonte marrëdhënien e punës, pasi ishte derivat dhe i kushtëzuar nga rezultati i procedimit penal në ngarkim të gjyqtarës M. A.. Në këtë linjë, edhe urdhri i dytë, ai për përfundimin e marrëdhënies së punës e lirim nga detyra të subjektit të rivlerësimit është rrjedhojë e dënimit të gjyqtarës M. A.. Në një interpretim në të kundërt, nëse përfundimi i marrëdhënies së punës, sikurse ka vlerësuar Komisioni, kishte ndodhur së bashku me pezullimin, urdhri i lirim nga detyra do të ishte i panevojshëm.

⁴ Në zbatim të një urdhri të ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, nr. 5151, datë 28.10.2015, "Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore të përfshira në fushën e shërbimit civil".

9.10. Po ashtu, nën dritën e sa u analizua më sipër, është i gabuar edhe konkluzioni tjetër i Komisionit, e konkretisht se subjekti i rivlerësimit nuk plotësonte as kushtet për t’u konsideruar ish-këshilltar, duke mos plotësuar kriterin e përvojës trevjeçare, të parashikuar nga Kushtetuta. Në kushtet që marrëdhënia e punësimit është zgjidhur në korrik 2017, ndërkohë që ishte lidhur përreth 3,5 vjet më parë, në shkurt 2014, Komisioni duhet ta kishte analizuar kërkesën e tij për t’iu nënshtruar rivlerësimit kalimtar edhe në këtë këndvështrim, në funksion të qëllimit për të cilin është krijuar procesi i rivlerësimit. Në këtë vlerësim, trupi gjykues i Kolegjit vëren se nga aktet në fashikull, rezultojnë disa fakte me rëndësi në këtë kontekst. Pas përfundimit të marrëdhënies së punës me Gjykatën e Lartë, subjekti ka shprehur vullnetin për t’iu nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, “pavarësisht se përfundimi i mandatit/detyrës erdhi për shkaqe natyrale, që ishte mbarimi i mandatit të gjyqtari”.

9.11. Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit konkludon se subjekti i rivlerësimit nuk e kishte humbur statusin e ndihmësit/këshilltarit ligjor në momentin e hyrjes në fuqi të kuadrit ligjor që normoi sistemin e rivlerësimit, pasi pezullimi nga ushtrimi i detyrës nuk përbën zgjidhje të marrëdhënies së punësimit e as ka efekt mbi fitimin e këtij statusi sipas Kushtetutës e ligjit nr. 96/2016. Për rrjedhojë, ky shkak ankimi i Komisioneres Publike është i bazuar.

10. Lidhur me vullnetin e subjektit për t’iu nënshtruar procesit të rivlerësimit:

10.1. Komisionerja Publike parashtron se ndaj subjektit të rivlerësimit Periand Teta, duhet të ndërpritet procesi i rivlerësimit dhe të aplikohet neni G i Aneksit të Kushtetutës, pasi me veprimet e tij, pas përfundimit të marrëdhënies së punës me Gjykatën e Lartë, ndonëse nuk ka akt të shkruar të dorëheqjes, nëpërmjet fillimit të detyrës së re, ka dhënë pëlqim të heshtur për mbarimin e statusit të ndihmësit/këshilltarit ligjor. Mungesa e kundërshtimit të urdhrin nëpërmjet të cilit përfunduan marrëdhëniet e punës për shkak të të cilave ai ka fituar statusin e subjektit të rivlerësimit dhe fillimi i një detyre të re, sipas Komisioneres Publike, përbën shprehje të dakordësisë/pëlqimit të heshtur që vlerësohet si dorëheqje nga detyra.

10.2. Subjekti pretendon se vendimi i Komisionit është i drejtë. Marrëdhënia e tij e punës me Gjykatën e Lartë ka përfunduar për shkaqe të ligjshme e të pavarura prej tij. Nuk ka dorëheqje apo veprim që dikton përfundimin e marrëdhënies së punës. Subjekti po ashtu thekson se nuk ekziston lidhje shkakësore mes vullnetit/veprimeve të ndërmarra prej tij kundrejt përfundimit të marrëdhënies së punës, për shkak të së cilës ai i nënshtrohet procesit të rivlerësimit. Në zbatim të ligjit të kohës, kohëzgjatja e detyrës së ndihmësit ligjor ishte e kushtëzuar me mandatin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Subjekti thekson se e ka treguar vullnetin për t’iu nënshtruar procesit të rivlerësimit nëpërmjet dërgimit të shkresave në institucionet përkatëse, ndërsa fillimi i detyrës së re lidhet me nevojën ekonomike dhe profesionale.

10.3. Në parashtrimet në Kolegj, subjekti potencoi se në periudhën kohore menjëherë pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës, për shkak të ndryshimeve të rëndësishme të ligjeve që rregullonin vijimësinë profesionale të këshilltarëve ligjorë, sikurse edhe për shkak të hyrjes në fuqi të ligjeve në kohë të ndryshme, nuk kishte pritshmëri për kthim në detyrën për shkak të së cilës ishte subjekt rivlerësimi. Këtë vlerësim, ai e mbështet në faktin që marrëdhënia e punës ishte lidhur

mbi bazën e kuadrit legjislativ që ishte në fuqi përpara ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016, sikurse edhe përpara kuadrit ligjor të rivlerësimit. Pavarësisht nga këto kushte, në zbatim të nenit 165 të ligjit nr. 96/2016, iu nënshtrua provimit në Shkollën e Magjistraturës, sikurse edhe kërkoi të vijonte procesi i rivlerësimit për të, qoftë edhe si ish-këshilltar.

10.4. Gjatë procesit të zhvilluar në Kolegj, subjekti ka përcjellë kërkesëpadinë e depozituar prej tij në korrik të vitit 2017, me palë të paditur Gjykatën e Lartë, nëpërmjet së cilës ka kërkuar detyrimin e këtij institucioni të paguajë pagat dhe sigurimet e papaguara gjatë periudhës së pezullimit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në datën 21.02.2018, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadsisë, duke arsyetuar ndër të tjera se përfundimi i marrëdhënies së punës ishte për shkak të ligjshëm, sipas dispozitave të ligjit nr. 8588/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë”. Ky vendim është ankimuar nga subjekti dhe është në pritje për shqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

10.5. Nga analiza e pretendimeve dhe akteve në fashikull nën dritën e dispozitave kushtetuese e ligjore, trupi gjykues i Kolegjit arriti në konkluzionin që kërkesa e Komisioneres Publike në ankim, lidhur me ndërprerjen e procesit dhe aplikimin e nenit G, pasi subjekti me veprime konkludente ka dhënë dorëheqjen nga detyra, është e pabazuar. Sikurse rezulton nga të gjithë aktet në fashikull, subjekti i rivlerësimit dëshmoi në mënyrë të qartë vullnetin e tij të shprehur për t’iu nënshtruar procesit të rivlerësimit edhe si ish-këshilltar ligjor. Në këto kushte, zbatimi i ndalimit nga neni G i Aneksit të Kushtetutës do të ishte i pabazuar sikurse edhe disproporcional. Arsyetimi mbi të cilin bazohet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

10.6. Së pari, trupi gjykues sjell në vëmendje që subjekti ka plotësuar deklaratat në funksion të procesit të rivlerësimit. Në vijim të urdhrin të datës 25.07.2017 nëpërmjet të cilit përfundoi marrëdhënia e tij e punës, subjekti ka rikonfirmuar vullnetin e tij për t’iu nënshtruar procesit, qoftë edhe si *ish-këshilltar*, sikurse pasqyrohet në shkresën dërguar ILDKPKI-së që mban datën 01.08.2017, dërguar Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD) në datën 28.07.2017 dhe Drejtorisë së Informacionit të Klasifikuar (DSIK). Subjekti shprehet se ka zgjedhur t’i drejtohet këtyre organeve në kushtet që organet e rivlerësimit në atë moment kohor nuk ishin ngritur ende.

10.7. Së dyti, i njëjti vullnet i pavesuar për t’iu nënshtruar procesit të rivlerësimit dëshmohet gjatë gjithë harkut kohor të ndërmjetëm, deri në dërgimin nga Komisioni të rezultateve të hetimit. Konkretisht, subjekti ka qenë bashkëpunues gjatë hetimit administrativ duke i kthyer përgjigje pyetësorit të vetëm të dërguar nga Komisioni dhe ka përcjellë edhe dokumentacion ligjor mbështetës për përgjigjet e dhëna prej tij, përfshirë fatura shpenzimesh të kryera. Nga ana tjetër, është i saktë pretendimi i Komisioneres Publike që nuk ka ndodhur asnjë ndryshim i rrethanave faktike apo ligjore të subjektit të rivlerësimit Periand Teta në harkun kohor gati dy-vjeçar mes nisjes së hetimit dhe dërgimit të rezultateve të hetimit nga Komisioni. Ka qenë vetë Komisioni që për herë të parë ka vlerësuar se subjekti nuk e gëzonte me këtë cilësi për shkak të periudhës një-vjeçare të pezullimit, qoftë edhe si ish-këshilltar/ndihmës ligjor. Me fjalë të tjera, përfundimi i procesit pa një vendim përfundimtar, pasi procesi kishte zgjatur përreth 22 muaj, pasqyron shprehimisht dhe ekskluzivisht një qëndrim të Komisionit, në datë 19.04.2023.

10.8. Së treti, trupi gjykues i Kolegjit vëren se edhe në procesin e zhvilluar në Kolegj nëpërmjet kërkimit alternativ, subjekt ka rikonfirmuar vullnetin për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit ashtu sikurse edhe nëpërmjet kërkimit përfundimtar. Konkretisht, subjekti ka kërkuar si alternativë të zgjidhjes së çështjes nga Kolegji edhe urdhërimin e Komisionit për të vijuar procesin e rivlerësimit kalimtar për të. Këto rrethana trupi gjykues i vlerësoi në analizën tërësore të gjithë sjelljes së tij *vis a vis* procesit të rivlerësimit.

10.9. Trupi gjykues i gjeti bindëse shpjegimet e subjektit për situatën ligjore që rezultonte në këtë moment kohor vlerësuar hyrjes në fuqi në kohë të ndryshme të ligjeve që gjejnë zbatim në rrethanat ligjore të tij, duke mos gjetur shkas për të identifikuar vullnetin për të evituar rivlerësimin. Në këtë kontekst, dhe në vijim të këtyre konstatimeve, trupi gjykues i Kolegjit e sheh të pabazuar kërkimin e Komisioneres Publike për zbatimin e ndalimit nga neni G i Aneksit të Kushtetutës për subjektin e rivlerësimit pasi në rrethanat faktike e ligjore konkrete nuk gjen vend as ndërprerja e procesit të rivlerësimit.

10.10. Së fundmi, trupi gjykues vëren se ky vlerësim është në linjë edhe me vendime të mëparshme të Kolegjit për aspekte relevante në analizën e vullnetit të shprehur apo të nënkuptuar [me veprime konkludente] të subjekteve të rivlerësimit për t'iu nënshtruar rivlerësimit, përfshirë edhe ata që sikurse z. Teta, kryenin detyrën e këshilltarëve ligjorë. Në këtë vlerësim, trupi gjykues ka në konsideratë jo vetëm subjektet këshilltarë ligjorë që kanë pasur vlerësim të ndryshëm për faktin nëse e gëzonin këtë cilësi për shkak të dinamikës së punësimit, por edhe subjekte për të cilët është konstatuar pëlqim i heshtur i punësimit brenda të njëjtit institucion apo që kanë kontestuar shkakun e humbjes së kësaj cilësie vetëm gjatë një intervali kohor, duke dëshmuar në thelb që kontestimi kryhet pa qenë objektiv në vetvete, kryer vetëm dhe për sa kohë vlerësohej e dobishme për procesin e hetimit administrativ në Komision. Në ndryshim nga këto analiza e vlerësime të kryera më parë nga Kolegji, subjekti i rivlerësimit ka qenë konsistent në vullnetin për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit, i është nënshkruar atij për kohëzgjatjen përkatëse diktuar nga veprimet e Komisionit, ka përmbushur detyrimet ligjore në këtë drejtim. Megjithëse nuk është më në detyrën e ndihmësi/këshilltarit ligjor, ai duhet të rivlerësohet si ish-ndihmës/ish-këshilltar ligjor me kërkesë, pasi, siç pranohet edhe nga Komisionerja Publike, pezullimi nga detyra nuk e cenoi kriterin tre vjeçar të vjetërsisë në këtë funksion.

11. Në përmbledhje, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ka qenë i gabuar qëndrimi i Komisionit për përfundimin e procesit të rivlerësimit pa një vendim përfundimtar për shkak se z. Periand Teta nuk është subjekti i ligjit nr. 84/2016. Duke u gjendur në detyrën e ndihmësit/këshilltarit ligjor jomagjistrat në momentin e ndryshimeve kushtetuese, të miratuara me ligjin nr. 76/2016, z. Periand Teta përfshihet në rrethin e subjekteve të rivlerësimit sipas pikës 4 të nenit 179/b të Kushtetutës, e për pasojë ai duhet t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar. Gjithashtu, kërkesa e subjektit për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit menjëherë, sapo u qartësua situata e vijimësisë së marrëdhënies së punës me Gjykatën e Lartë, vlerësohet si e rivendosur në afat, e që konfirmon vullnetin e tij për t'iu nënshtruar këtij procesi.

12. Në këto kushte dhe duke mos konstatuar në asnjë formë dhe gjatë gjithë harkut kohor të analizuar, vullnet të shprehur apo veprime konkludente të subjektit të rivlerësimit për t'iu shmangur procesit të rivlerësimit, trupi gjykues e gjen të pabazuar kërkesën e Komisioneres Publike për aplikimin e

nenit G të Aneksit të Kushtetutës në rrethanat konkrete. Për rrjedhojë, pasi analizoi pretendimet e ngritura në ankim nga Komisionerja Publike dhe ato të paraqitura në kundërankim e parashtrime në Kolegj nga subjekti i rivlerësimit, nën dritën e legjislacionit të zbatueshëm, trupi gjykues arrin në konkluzionin se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 657, datë 28.04.2023, duhet të priset dhe Komisioni të urdhërohet të kryejë procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, si ish-këshilltar ligjor.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Prishjen e vendimit nr. 657, datë 28.04.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
2. Urdhërimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit të vijojë procesin e rivlerësimit kalimtar për z. Periand Teta.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

U shpall sot, më datë 17.07.2024, në Tiranë.

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

RELATORE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

KRYESUESE

Mimoza TASI

nënshkrimi